



## KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 01-112/02-137821/21, dat:22.Dhjetor 2021

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 pika d), nenit 51. paragrafi 1 dhe nenit 52. paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04.qershor 2008”), nenit 3 dhe nenit 6 paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë dt. 21.12.2020, dhe nenit 37 paragrafi 1. pika 1.1 dhe nenit 41. të Statutit të Komunës së Pejës I.Nr.01-016/01-413431 datë: 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 22. Dhjetor 2021, në propozim të anëtarëve të kuvendit, merr

### V E N D I M

Nr.02/2021

### MBI THEMELIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË E FINANCA

1.Themelohe Komiteti për Politikë e Financa i Kuvendit Komunal Pejë, në këtë përbërje prej 9 (nëntë) anëtarësh, si komitet i përhershëm dhe trupë ndihmës i kuvendit, në përbërje:

1.Rexhep Kurtbogaj, kryesues i Kuvendit të Komunës,		kryesues,
2.Dritë Maloku, nga subjekti politik	LDK	anëtare,
3.Myrvete Salihu , - / -	LDK	anëtare,
4.Mentor Bajri,	LDK	anëtarë,
5.Zize Hakaj Veselaj ,	AAK	anëtare,
6.Labinot Panxhaj,	AAK	anëtarë,
7.Hidajete Nikçi	LVV	anëtarë,
8.Berat Ganiqi	LVV	anëtarë, dhe
9.Xhevahire Çeku Kelmendi,	PDK	anëtare.

2.Kompetencat – të drejtat dhe përgjegjësit e Komitetit për Politik e Financa, janë përcaktuar me nenin 52. të LVL –së, nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.02/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, dhe me nenin 42 të Statutit të Komunës së Pejës.

3.Kompenzimi i anëtarëve të komiteteve është i përcaktuar me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2008 për pagesën e stafit politik në komuna, “Pjesëmarrja në çdo seancë të punës së komiteteve kompensohet si shtesë në lartësi maksimale prej 50 € (euro).

4.Mandati i anëtarëve të Komitetit për politikë dhe financa është 4 vjeçar dhe përfundon me përfundimin e mandatit të kuvendit të komunës.

5.Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet e Financa e KK.Pejë.

6.Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Vendimi ti dërgohet:**

- 1x1 MAPL-së
- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Anëtarëve të komitetit
- 1x1.DBF-ca
- 1x1 Arkivë.

